



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seanca e Kuvendit

P- 021

Prishtinë, më 23 maj 2008, në orën 17:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA E KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 MAJ 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 94 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me vendimin e shefit të UNMIK-ut, që prej sot deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës është deputeti Dragan Dimiq.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit lidhur me Raportin dhe rekomandimet e Komisionit ad hoc, që ia kishte dërguar Kuvendit për procedimin e Projektligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me të.

Kryetari e ftoi kryesuesin e Komisionit ad-hoc që ta paraqesë Raportin me rekomandime.

Deputeti **Fehmi Mujota** tha se Komisioni ad-hoc, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjet e mbajtura më 22 dhe 23 maj 2008, shqyrtoi Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, të propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë

R A P O R T

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës dhe njëzëri ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit për miratim të Projektligjit, me amendamentet e propozuara.

Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit dhe të propozimeve që janë parashtruar për amendamentimin e tij, ka bërë atë që ka qenë më e mundshme dhe më e mira për momentin e caktuar, si një formë kompromisi në mes mocionit që është menduar në nenin 2 pika 2 dhe në mes të asaj që të mos ketë asnjë ndryshim në Ligj.

Prandaj, kompromisi është në nenin 5 pika 5, në të cilin i kemi përfshirë edhe festat që shënohen me krenari, do të them, edhe nga shumica edhe nga pakica.

Komisioni ka hartuar dy amendamente. Njëri nuk ka të bëjë me ndryshim thelbësor, përveç se data e Kushtetutës precizohet si datë 9 prill dhe një tjetër, që zëvendësohet numri 6 me numrin 7. Ndërsa, festat e renditura janë sipas asaj që të gjithë jemi pajtuar në Komision: datën e 28 nëntorit si Ditë e Shqiptarëve, 12 qershori - Ditë e Paqes, 6 marsi - Ditë e Përkujtimit dhe Respektit për Veteranët, si dhe kemi festat për pakicat, në këtë rast: 23 prilli - Ditë e Turqve, 8 prilli - Ditë e Romëve, 15 shkurti - Ditë e Hashkalinjve, 28 shtatori - Ditë e Boshnjakëve, 6 maji - Ditë e Goranëve dhe ditët e tjera memoriale përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në konsultim me Presidentin e Republikës së Kosovës, nga të cilat, dy ditë - në konsultim me komunitetin serb të Kosovës. Kjo është çështje që do të rregullohet më vonë, në konsultim me Këshillin e komunitetit serb.

Në fund, deputeti Mujota në emër të Komisionit ad hoc kërkoi që Kuvendi ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad hoc.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentet një dhe dy.

Në fund, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----46,
Kundër-----32,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17: 50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale